

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Drejtimin Mësimor**

**GJEOLOGJI-MINIERA**

**Niveli IV i KSHK**  
**(1 vjeçar)**

**Kodi: I-IV-21**

Miratoi:

**MINISTRI**

**Tiranë, 2021**

## **Përmbajtja:**

**I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i (KSHK).**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.

**III. Plani mësimor për drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me punimet në gjeologji-miniera, si dhe për të vijuar arsimin e lartë dhe formimin profesional të mëtejshëm”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga profilet e nivelit III të KSHK, të drejtimin mësimor “Gjeologji-miniera”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi që lidhet me veprimtaritë në gjeologji dhe miniera.
- Të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtaritë në gjeologji dhe miniera.
- Të bëjë organizimin e punës në një sektor të veçantë të ndërmarrjeve/kompanive në gjeologji-miniera.
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare gjatë veprimtarive të punës në gjeologji-miniera.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik dhe financiar që lidhet me veprimtaritë që kryhen në gjeologji dhe miniera.
- Të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive në gjeologji-miniera.
- Të zbatojë standartet teknike të miratuara që veprojnë në gjeologji dhe miniera.
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale në gjeologji-miniera.
- Të ndërtojë skica teknike të punimeve gjeologo-minerare me programin *AutoCAD*.
- Të kryejë llogaritje për konstruksione të thjeshta të armaturave në gjeologji-miniera.
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit (TIK) për shërbimet në gjeologji-miniera.
- Të monitorojë përdorimin e pajisjeve dhe makinerive në gjeologji-miniera.
- Të kryejë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë në gjeologji-miniera.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në gjeologji-miniera.

### **4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.**

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me

Çertifikatën e teknikut të gjeologji-minierave.

Ky kualifikim i jep mundësi individit t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar në ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitet në drejtimin gjeologji-miniera. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e gjeologji-minierave në profesionet: teknik miniere, teknik gjeolog, teknik markshajder, teknik shpimi, etj. Po ashtu, në varësi të profilit të përfutur në nivelin e mëparshëm, ai mund të punësohet në një biznes që operon në fushën e gjeologji-minierave, në sektorët e prodhimit e të mirëmbajtjes, në linjat e prodhimit të inerteve në minierat sipërfaqësore, nëntokësore etj.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit të mëtejshëm në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

### III. Plani mësimor për drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për drejtimin “Gjeologji-miniera”, niveli IV i KSHK.			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 13
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>15/16</b> (480/512)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		Fizikë	1
7		Biologji	2
8		Shkenca sociale	1
9		Histori	1
10		Gjeografi	1
11		TIK	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>9</b> (288)
1	L-17-197-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-15-422-16	Organizimi dhe ligjshmëria në gjeologji-miniera	1
4	L-01-423-16	Përdorimi i <i>AutoCAD</i> në gjeologji-miniera	1
5	L-15-424-16	Hapja dhe ndërtimi i punimeve speciale në gjeologji-miniera	4
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale</b> (Gjithsej)	<b>6</b> (192)
1	M-15-1300-20	Krijimi dhe organizimi i një ndërmarrjeje në gjeologji-miniera	51
2	M-01-1301-20	Vizatimet teknike me <i>AutoCAD</i> në gjeologji-miniera	51
3	M-15-1302-20	Projektimi dhe ndjekja e punimeve në një guror të vogël	90

		<b>Gjithsej A+B+C</b>	<b>30/31</b> (960/ 992)
--	--	-----------------------	-------------------------------

### • Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin mësimor "Gjeologji-Miniera", niveli IV i KSHK, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

### V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është **integrimi i teorisë me praktikën** e profesionit. Parimi i "të nxënësit duke bërë" duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit mësimor "Gjeologji-miniera", niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodave të "*simulimit*" dhe të "*lojës me role*", ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna

kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional "Gjeologji-miniera".

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në drejtimin mësimor "Gjeologji-miniera", niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale (sipas udhëzimeve të MASR) si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar (sipas udhëzimeve të MFE).

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor "Gjeologji-miniera", niveli IV i KSHK.**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor "Gjeologji-miniera", niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën teknikut në teknologjinë kimike, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13;

- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-20). Kl. 13 – 64 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë

<b>Tema 1</b>	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
<b>Tema 2</b>	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
<b>Tema 3</b>	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
<b>Tema 4</b>	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
<b>Tema 5</b>	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
<b>Tema 6</b>	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
<b>Tema 7</b>	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
<b>Tema 8</b>	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
<b>Tema 9</b>	Buxhetimi në biznes	4 orë
<b>Tema 10</b>	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
<b>Tema 11</b>	E – sipërmarrja	2 orë
<b>Tema 12</b>	Veprimet individuale me bankat	3 orë
<b>Tema 13</b>	Siguracionet personale	3 orë



## 2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 32 orë

### • Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 32 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
<b>Tema 2</b>	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
<b>Tema 3</b>	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
<b>Tema 4</b>	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	3 orë
<b>Tema 5</b>	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
<b>Tema 6</b>	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
<b>Tema 7</b>	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
<b>Tema 8</b>	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
<b>Tema 9</b>	Veprimtari praktike për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal	3 orë
<b>Tema 10</b>	Veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

## 3. Lënda “Organizimi dhe ligjshmëria në gjeologji-miniera” (L-15-422-16). Kl. 13 – 32 orë

### • Synimet e lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në gjeologji-miniera”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në gjeologji-miniera”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë strukturën organizative (organigramën) e një ndërmarrje/kompanie që operon në fushën e gjeologji-minierave;
- Të përshkruajnë drejtimit e karrierës dhe përshkrimet e punës në gjeologji-miniera;
- Të përshkruajnë ndarjen e detyrave dhe organizimin e punës në një ndërmarrje apo kompani në gjeologji-miniera;
- Të analizojnë llojet dhe format ligjore të bizneseve në fushën e gjeologji-minierave;

- Të analizojnë marrëdhëniet juridike të të punësuarve në fushën e gjeologji-minierave;
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe normativ që vepron në fushën e gjeologji-minierave
- Të përshkruajnë standardet ndërkombëtare të miratuara që veprojnë në fushën e gjeologji-minierave;
- Të përshkruajnë rregullat e etikës profesionale dhe të komunikimit në një biznes të gjeologji-miniera;
- Të përshkruajnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në gjeologji-miniera.
- Të njohin konkretisht organizimin e punës në një ndërmarrje apo kompani të gjeologji-minierave.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në gjeologji-miniera”, kl.13 - 32 orë**

<b>Tema 1</b>	Strukturat organizative të një ndërmarrje në gjeologji-miniera.	2 orë
<b>Tema 2</b>	Karriera e punësimeve dhe përshkrimet e punës të personelit në gjeologji-miniera	6 orë
<b>Tema 3</b>	Ndarja e detyrave dhe organizimi i vogël i punës në një ndërmarrje në gjeologji-miniera	4 orë
<b>Tema 4</b>	Llojet dhe format ligjore të bizneseve në fushën e gjeologji-minierave	2 orë
<b>Tema 5</b>	Marrëdhëniet juridike të të punësuarve në fushën e gjeologji-miniera	2 orë
<b>Tema 6</b>	Kuadri ligjor dhe normativ që vepron në fushën e gjeologji-minierave	2 orë
<b>Tema 7</b>	Standardet ndërkombëtare që veprojnë në fushën e gjeologji-minierave	4 orë
<b>Tema 8</b>	Etika profesionale dhe komunikimi në një biznes të gjeologji-miniera	2 orë
<b>Tema 9</b>	Rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e mjeteve të transportit	2 orë
<b>Tema 10</b>	<u>Vizitë në ndërmarrje apo kompani</u> për njohjen me organizimin e punës në gjeologji-miniera	6 orë

**4. Lënda “Përdorimi i *AutoCAD* në gjeologji-miniera” (L-01-423-16). Kl. 13 – 32 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Përdorimi i *AutoCAD* në gjeologji-miniera”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë programin e *AutoCAD* që përdoret në gjeologji-miniera për hartimin e skicave dhe fletëve të projektit në gjeologji-miniera (në sipërfaqe dhe nëntokë).
- Të njohin menunë e ekranit, tastat funksionale dhe radhën e veprimeve.
- Të krijojnë ambjentin e punës së *AutoCAD*.
- Të ndërtojnë figurat gjeometrike nëpërmjet komandave të *AutoCAD*.
- Të njohin metodat e editimit (kopjim, zhvendosje, fshirje, selektim).
- Të krijojnë dhe përcaktojnë shtresat, ngjyrat, tipat e vijave.
- Të njohin përdorimin e blloqeve të vizatimit të *AutoCAD*.
- Të hartojnë tekstin dhe atributet e tjera në vizatim.
- Të plotësojnë vizatimin me të gjitha elementet dhe të nxjerrë në letër vizatimin (printimi).

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Përdorimi i *AutoCAD* në gjeologji-miniera”, kl.13 - 32 orë**

<b>Tema 1</b>	Njohuri për programin <i>AutoCAD</i> që përdoret në ndërtim	3 orë
<b>Tema 2</b>	Njohuri për krijimin e ambientit të punës së <i>AutoCAD</i>	2 orë
<b>Tema 3</b>	Hartimi i vizatimeve nëpërmjet <i>AutoCAD</i>	10 orë
<b>Tema 4</b>	Njohja me metodat e editimit (kopjim, zhvendosje, fshirje, selektim)	10 orë
<b>Tema 5</b>	Hartimi i teksteve dhe attributeve në vizatim	4 orë
<b>Tema 6</b>	Nxerrja në letër e vizatimeve (printimi)	3 orë

## 5. Lënda “ Hapja dhe ndërtimi i punimeve speciale në gjeologji-miniera” (L-15-424-16). Kl.13 – 128 orë

### • Synimet e lëndës “Hapja dhe ndërtimi i punimeve speciale në gjeologji-miniera”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Hapja dhe ndërtimi i punimeve speciale në gjeologji-miniera”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë veçoritë e parashpënjes së punimeve me ballë të ngushtë.
- Të tregojnë procedurën e organizimit të punës për parashpënjën me ritme të larta.
- Të përshkruajnë veçoritë e parashpënjes së punimeve me ball të gjërë.
- Të përshkruajnë ndërtimin e dishenterive me ball të ngushtë në shkëmbinjtë homogjenë e heterogjenë.
- Të përshkruajnë veçoritë e ngarkimit dhe të transportit në punimet e pjerrëta.
- Të rendisin punët e shpim plasjes në pusët vërtikale.
- Të përshkruajnë mënyrat e armatimit të puseve vërtikale.
- Të përshkruajnë veçoritë e hapjes së oxhakëve në qymyre me çekiçë rrëzues.
- Të përshkruajnë veçoritë e hapjes së rimontave në minierat metalore.
- Të përshkruajnë veçoritë e ndërtimit të punimeve minerare me seksion të madh dhe të ndryshueshëm.
- Të hartojnë pasaportën e një punimi të pjerrët me treguesit kryesor tekniko-ekonomik.
- Të përshkruajnë pajimin e punimeve minerare vertikale dhe të pjerrëta.
- Të përshkruajnë armatimin e punimeve minerare me armaturë paraecëse dhe me mburojë.
- Të përshkruajnë ndërtimin e punimeve minerare me tamponim paraprak të shkëmbinjëve anësorë.
- Të përshkruajnë riparimin, rimëkëmbjen dhe rikonstruksionin e punimeve minerare horizontale.
- Të përshkruajnë riparimin dhe rimëkëmbjen e punimeve minerare vërtikale.
- Të përshkruajnë riparimin dhe rimëkëmbjen e lidhjeve të punimeve minerare.
- Të përshkruajnë konceptet kryesore për rezervat e mineralit të dobishëme.
- Të përshkruajnë kategoritë e rezervave të mineralit të dobishëm
- Të përshkruajnë humbjet dhe varfërimin e mineraleve të dobishme.
- Të përshkruajnë punimet minerare në qiell të hapur, llojet e tyre dhe elementet përbërës.
- Të rendisin mënyrat e hapjes së vendburimeve në qiell të hapur.
- Të analizojnë faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e mënyrës së hapjes.
- Të përshkruajnë shkallët e karrierës, elementet përbërës dhe mënyrat e vendosjes.
- Të analizojnë faktorët për zgjedhjen e sistemit të shfrytëzimit në qiell të hapur.
- Të radhisë elementet e sistemeve të shfrytëzimit në qiell të hapur.

- Të përshkruajnë rrëzimin, ngarkimin dhe transportin e mineralit dhe të shkëmbit.
- Të përshkruajnë rrëzimin me puse dhe dhoma minash.
- Të përshkruajnë pajisjet e shpimit në karrierë.
- Të përshkruajnë rrëzimin me lëndë plasëse.
- Të përshkruajnë rrëzimin me vrima të zakonshme e të thella minash.
- Të bëjnë llogaritjen e ngarkesave për rrëzimin me vrima minash.
- Të bëjnë llogaritjen e ngarkesave për rrëzimin me puse minash.
- Të bëjnë llogaritjen e ngarkesave për rrëzimin me dhoma minash.
- Të rendisin faktorët që ndikojnë në atmosferën e minierës dhe ndotjen e saj.
- Të përshkruajnë ajrimin e përgjithshëm të minierës.
- Të përshkruajnë skemat e ajrimit të minierës.
- Të llogarisin sasinë e nevojshme të ajrit në minierë dhe në punime të veçanta.
- Të përdorin pajisjet e matjeve të ajrimit në minierë.
- Të identifikojnë shkaqet e shpërthimit të ujrave dhe përbërjen e tyre.
- Të veçojnë stacionet lokale dhe qendrore të pompimit të ujrave.
- Të përshkruajnë pajisjet për largimin e ujrave nga nëntoka.
- Të bëjnë llogaritjet e largimit të ujrave me anë të pompave.
- Të përshkruajnë rëndësinë e përdorimit të ajrit të ngjeshur në minierë.
- Të përshkruajnë llojet e kompresorave në minierë.
- Të përshkruajnë rrjetin e shpërndarjes së ajrit në minierë.
- Të bëjnë llogaritjet e rrjetit të ajrit të ngjeshur.
- Të bëjnë llogaritjet e sasisë së ajrit në degëzime dhe në stacionin prodhues.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Hapja dhe ndërtimi i punimeve speciale në gjeologji-miniera”, kl.13 – 128 orë**

<b>Tema 1</b>	Veçoritë e parashpënjes në punimet minerare horizontale	6 orë
<b>Tema 2</b>	Veçoritë e parashpënjes në punimet minerare të pjerrëta	8 orë
<b>Tema 3</b>	Veçoritë e parashpënjes në punimet minerare vertikale	10 orë
<b>Tema 4</b>	Punët e shpim-plasjes në puse	4 orë
<b>Tema 5</b>	Armatimi i puseve	8 orë
<b>Tema 6</b>	Veçoritë e ndërtimit të punimeve me seksion të madh dhe të ndryshueshëm	6 orë
<b>Tema 7</b>	Pajimi i punimeve minerare	6 orë
<b>Tema 8</b>	Mënyrat e posaçme të ndërtimit të punimeve minerare	8 orë
<b>Tema 9</b>	Riparimi, rimëkëmbja dhe rikonstruksionet e punimeve minerare	8 orë
<b>Tema 10</b>	Njohuri të përgjithshme për shfrytëzimin e vendburimeve të mineraleve të dobishme.	4 orë
<b>Tema 11</b>	Mënyrat e hapjes dhe të përgatitjes së vendburimeve për shfrytëzimin me qiell të hapur	6 orë
<b>Tema 12</b>	Sistemet e shfrytëzimit në qiell të hapur	6 orë
<b>Tema 13</b>	Proceset teknologjike të shfrytëzimit me qiell të hapur	10 orë
<b>Tema 14</b>	Përgatitja e vendburimeve për shfrytëzim nëntokësor	4 orë
<b>Tema 15</b>	Ajrimi i minierës	10 orë
<b>Tema 16</b>	Pajisjet e ajrimit të minierës	10 orë
<b>Tema 17</b>	Largimi i ujrave nga miniera	6 orë
<b>Tema 18</b>	Furnizimi i minierës me ajër të ngjeshur	8 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli: “Krijimi dhe organizimi i një ndërmarrjeje në gjeologji-miniera”

Drejtimi: Gjeologji-miniera  
Niveli: IV i KSHK  
Klasa: 13

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	<b>KRIJIMIN DHE ORGANIZIMI I NJË NDËRMARRJEJE NË GJELOGJI-MINIERA</b>	<b>M-15-1300-20</b>
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer veprimet dhe hartuar dokumentet e krijimit të një ndërmarrjeje në gjeologji-miniera, përcaktuar formën juridike të saj dhe për të rekrutuar personelin përkatës.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të III të KSHK, të drejtimit mësimor “Gjeologji-miniera”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi bën studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes në gjeologji-miniera.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të përcaktojë llojin e veprimtarisë së ndërmarrjes.</li><li>- të planifikojë sasinë e shitjeve dhe blerjeve, që do të realizojë ndërmarrja;</li><li>- të planifikojë shpenzimet dhe të ardhurat nga shitja.</li><li>- të parashikojë kostot për njësi të prodhimi, qoftë e mirë ose shërbim që do të ofrohet.</li><li>- të planifikojë kostot fikse të ndërmarrjes, për ushtrimin e veprimtarisë së saj;</li><li>- të planifikojë shpenzimeve të tjera të ndryshueshme, në varësi të llojit të veprimtarisë;</li><li>- të parashikojë rezultatin ekonomik, mbi bazën e treguesve të mësipërm</li><li>- të hartojë planin e biznesit, duke përmbledhur në të, të gjitha parashikimet e kryera;</li><li>- të planifikojë saktë nevojat për financime, duke u mbështetur mbi planin e biznesit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul>	
	<b>RM 2 Nxënësi aplikon për regjistrim në organet përkatëse.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b>	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme për ndërmarrjen, sipas mundësive të financimit dhe kërkesave të pronarëve;
- të plotësojë dokumentacionin për krijimin e ndërmarrjes, sipas formës së saj juridike, duke shfrytëzuar burimet e duhura;
- të hartojë një statut dhe një akt të thjeshtë të themelimit të ndërmarrjes;
- të përcaktojë saktë dhe qartë mënyrën se si do të bëhet derdhja e kapitalit fillestar të ndërmarrjes;
- të përcaktojë strukturën organizative të ndërmarrjes, sipas formës juridike të saj;
- të plotësojë saktë formularët e aplikimit.
- të plotësojë të gjithë dokumentet që duhet të shoqërojnë aplikimin në QKL;
- të liçensohet pranë organeve përkatëse, duke ndjekur afatet e liçencimit në QKL dhe regjistrimit në QKR;
- të marrë në dorëzim çertifikatat e liçensimit (NIPT).

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### **RM 3 Nxënësi kryen procedurat e rekrutimit dhe të punësimit të personelit në ndërmarrjen e krijuar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbledhë informacion të saktë dhe të plotë nga sektorët e ndërmarrjes për nevojat për personel;
- të analizojë saktë dhe me përgjegjshmëri kërkesat e sektorëve për personel;
- të përcaktojë saktë nevojat për personel të ri, sipas sektorëve të ndërmarrjes;
- të hartojë formularët përmbledhës për personelin e ri;
- të marrë vendimin përfundimtar për personel të ri, sipas analizës së nevojave.
- të përcaktojë dokumentet dhe kriteret e nevojshme për vendet e lira të punës, sipas standardeve të kërkuara (Kërkesë punësimi, CV, dokumente vërtetuese të aftësive profesionale dhe personale të kandidatit);
- të reklamojë, sipas standardeve, vendet e lira të punës në media të pranojë dosjet e kandidatëve, sipas afatit kohor;
- të analizojë dosjet e kandidatëve për vendet e lira të punës;
- të seleksionojë dosjet e kandidatëve, sipas kriterëve;
- të hartojë kriteret e vlerësimit për kandidatët, sipas vendit të kërkuar të punës;
- të përgatisë intervista për kandidatët, duke saktësuar kriteret;
- të realizojë me profesionalizëm intervistat me kandidatët;
- të marrë vendimet për përzgjedhjen e kandidatëve, sipas vlerësimit objektiv të dokumenteve e intervistave të tyre;

- të informojë rezultatet e përzgjedhjes së personelit sektorëve përkatës;
- të hartojë kontratën e saktë të punës, duke u bazuar në legjislacionin dhe kodin e punës;
- të nënshkruajë kontratën e punës ndërmjet palëve;
- të regjistrojë personelin e ri në regjistrin themeltar të ndërmarrjes;
- të regjistrojë personelin e ri në zyrën e punës, sigurimet shoqërore dhe institutin e sigurimeve shëndetësore, duke e pajisur me librezat përkatëse;
- të regjistrojë personelin e ri në librin e pagave dhe shpërblimeve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale e nxënësit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e një ndërmarrjeje apo kompanie që vepron në gjeologji-miniera.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes, aplikimit për regjistrim, si dhe rekrutimin e punësimit e personelit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes, për përcaktimin e formës juridike dhe dokumentacionit bazë të saj, për identifikimin e nevojave për personel, si dhe rekrutimin e punësimit e tij.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes, për përcaktimin e formës juridike dhe dokumentacionit bazë të saj, për identifikimin e nevojave për personel, si dhe rekrutimin e punësimit e tij.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e procedurave për krijimin dhe organizimin e ndërmarrjes.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- mjedis i ndërmarrjes;
  - mjetet dhe pajisjet e punës, për krijimin e organizimin e ndërmarrjes;
  - mjete kancelarie, kompjuter ne lidhje me internetin.
  - program kompjuterik për menaxhimin e aktivitetit në ndërmarrje .
  - modele statutesh, aktesh themelimi, planesh biznesi, dosjesh aplikimi në QKL dhe QKR të marra nga ndërmarrje konkrete,
-

- 
- për krijimin dhe organizimin e ndërmarrjes;
- formularë regjistrimi në QKL dhe QKR;
  - pasqyra dhe deklarata për numrin e të punësuarve, kontrata me sigurimet shoqërore e shëndësore , deklarata të parashikimit të fitimit etj.
-



## 2. Moduli “Vizatime teknike me *AutoCAD* në gjeologji-miniera”

Drejtimi: Gjeologji-miniera

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VIZATIME TEKNIKE ME <i>AutoCAD</i> NË GJEOLOGJI-MINIERA	M-01-1301-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të realizuar vizatime teknike në gjeologji-miniera me anë të programit <i>AutoCAD</i> .	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të drejtimit mësimor “Gjeologji-miniera”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi parapërgatit realizimin e vizatimit teknik në gjeologji-miniera me <i>AutoCAD</i>.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të përzgjedhë një objekt sipërfaqësor (karrierë e vogël) ose nëntokësor (punim mineral, panel shfrytëzimi etj);</li><li>– të analizojë drejt objektin e përzgjedhur me anë të vizatimit teknik në <i>autocad</i> duke përcaktuar hapat e duhur;</li><li>– të përcaktojë parametrat e duhur, shkalla, etj etj, të vizatimit teknik që do të përgatitet;</li><li>– të skicojë sipas rregullave në letër (me dorë) draftin e objektit që do të realizohet me <i>autocad</i>;</li><li>– të vërë në punë kompjuterin sipas radhës së veprimeve;</li><li>– të hapë programin <i>autocad</i> specifik për vizatimin teknik që do të realizohet sipas radhës së veprimeve.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi realizon vizatimin teknik të objektit me <i>AutoCAD</i>.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të hapë një faqe të re për vizatimin teknik të objektit që do të realizohet duke respektuar radhën e veprimeve;</li><li>– të aplikojë sipas rregullave parametrat e kërkuar (formatin, shkallën, etj.);</li><li>– të zgjedhë dhe vendosë sipas rregullave sistemin e koordinatave.</li><li>– të realizojë vizatimin e objekteve të kërkuara (vija, rrahë, harqe, elipse, drejtkëndësha, shumëkëndësha, figura</li></ul>	

- komplekse etj.) duke respektuar llojet dhe trashësitë e ndryshme të vijave;
- të realizojë vizatimin e shtresave/layers sipas skicës së dhënë;
  - të aplikojë sipas rregullave efektet e ndryshme në vizatim;
  - të vendosë përmasat e sakta në vizatim;
  - të shkruajë tekstet dhe simbolet e kërkuara;
  - të realizojë ngjyrosjet dhe hijet e kërkuara sipas shenjave dalluese përkatëse;
  - të vendosë legjendën spjeguese të vizatimit/skicës/hartës
  - të bëjë sipas rregullave editimin e vizatimit teknik (selektime, prerje, zhvendosje, kopjime, ndryshim madhësie etj.);
  - të aplikojë filtrat sipas rregullave;
  - të ruajë, përgatisë për printim dhe printojë sipas rregullave dokumentin e hartuar.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasën ose laboratorin e praktikës së kompjuterave.
- Mësuesi\instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të veprimeve në kompjuter për realizimin e vizatimeve teknike në gjeologji-miniera me programin *AutoCAD*.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për përgatitjen, realizimin dhe printimin e vizatimeve teknike në gjeologji dhe miniera me programin *AutoCAD*, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Mësuesi\instruktori duhet të nxisë nxënësit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të çdo nxënësi.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë ose laborator kompjuterash.
  - Kompjuterat personalë me programin *AutoCAD* të instaluar.
  - Skica të gatshme dhe fletë projekti që do të vizatohen.
  - Video-projektor.
  - Flip-çhart.
  - Markera me ngjyra.
  - Printer.
  - Fomate letrash për vizatime teknike.
  - Manual i përdorimit të programit *AutoCAD*.
-

### 3. Moduli “Projektimi dhe ndjekja e punimeve në një gurore të vogël

Drejtimi: Gjeologji-miniera

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

#### PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PROJEKTIMI DHE NDJEKJA E PUNIMEVE NË NJË GURORE TË VOGËL	M-15-1302-20
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të realizuar dhe zbatuar projekte të punimeve të thjeshta gjeologo-minerare sipërfaqësore si shkallë kariere, rrugë të shkurtra, punime rehabilituese të ambjentit, etj.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të drejtimin mësimor “Gjeologji-miniera”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi bën vlerësimin e përgjithshëm paraparak të zonës ku do të hapet gurorja.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të marrë informacion për zonën ku do të zhvillohet aktiviteti gjeologo-minerar;</li><li>– të analizojë dokumentacionin hartografik dhe teknik të zonës;</li><li>– të bëjë një vlerësim të përafërt të rezervave minerare që do të përdoren;</li><li>– të përcaktojë parametrat kryesorë të gurores, kufijtë, thellësia etj;</li><li>– të përcaktojë trashësinë e shtresave që do të shfrytëzohen;</li><li>– të përcaktojë pjerrësinë e shpatit;</li><li>– të përcaktojë drejtimin e lëvizjes së ujrave;</li><li>– të përcaktojë anëtarët e ekipit të projektimit në përputhje me legjislacionin shqiptar.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul>	
	<p><b>RM 2 Nxënësi bën vlerësimin tekniko-ekonomik të gurores.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të gjejë informacion paraparak për punimet që nevojiten për hapjen e gurores;</li><li>– të gjejë informacion për pajisjet teknike që do të përdoren;</li><li>– të përgatisë listën e pajisjeve;</li><li>– të formulojë kërkesat për produktin (cilësia, sasia, etj);</li></ul>	

- të përcaktojë jetëgjatësinë e gurores;
- të përcaktojë logjistikën e nevojshme;
- të përcaktojë rrugët, instalimet elektrike, largimin e ujrave, etj.;
- të përcaktojë rregullat e nevojshme të sigurimit teknik.
- të përcaktojë buxhetin e nevojshëm.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi harton një projekt të thjeshtë teknik të hapjes dhe shfrytëzimit të gurores.**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ngrejë një grup projektimi;
- të bëjë një llogaritje të thjeshtë dhe të përgjithshme të rezervave;
- të përcaktojë parametrat e gurores;
- të dijë mënyrën e zhvillimit të shkallëve të gurores;
- të projektojë një rrugë të thjeshtë në gurore;
- të llogarisë kapacitetin vjetor të prodhimit;
- të përcaktojë metodën e hapjes së gurores;
- të përcaktojë metodën e shfrytëzimit;
- të përcaktojë teknologjinë e nxjerrjes së materialit;
- të përcaktojë rregullat e sigurimit teknik;
- të përcaktojë mënyrën e transportit të materialit;
- të bëjë një studim të thjeshtë të tregut të shitjes;
- të hartojë një projekt të thjeshtë për ruajtjen dhe rehabilitimin e ambientit.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi ndjek dhe zbaton elementë të veçantë të një projekti të thjeshtë teknik të hapjes dhe shfrytëzimit të gurores.**

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndjekë dhe zbatojë projektin e zhvillimit të punimeve (rradha, kalendari etj);
- të ndjekë dhe zbatojë projektin e hapjes së një shkalle në gurore, me të gjitha proceset e punës;
- të ndjekë dhe zbatojë projektin e ndërtimit të një rruge të shkurtër në gurore;
- të ndjekë dhe zbatojë projektin për ruajtjen dhe rehabilitimin e ambientit në një shkallë të gurores.

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve**

- Ky modul duhet të trajtohet fillimisht në klasë dhe pastaj praktikisht në një gurore;
- Mësuesi i praktikës duhet të demonstrojë procedurat e hapjes dhe shfrytëzimit të gurores duke përdorur literaturën dhe shembujt

---

konkretë përkatës.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e procedurave të hartimit të projektit teknik fillimisht në mënyrë të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat që kryejnë.
- Instruktori duhet të përdorë metodën e "lojës me role", ku nxënësit angazhohen në mënyrë të alternuar në rolet e projektuesit, zbatuesit apo të drejtuesit teknik të gurores.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për projektimin dhe zbatimin e projektit teknik.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë për hartimin e projektit;
  - Literaturë, shembuj të projektimit dhe hapjes së guroreve ose Karierave;
  - Kompjuter dhe programe kompjuterike për hartimin e projektit teknik.
  - Formate të dokumentacionit teknik për hartimin e projektit dhe Zbatimin të tij.
  - Udhëzuesa pune, rregullore dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-